

MNN QENDRORE



MISIONET NDËRKOMBËTARE NAZARETASE

12 Nëntor 2025

NJË SHIKIM I SHPEJTË MNN



Misionet Globale dhe Misionet Ndërkombëtare Nazaretase SË BASHKU!



Gjatë vitit të kaluar, Misionet Globale edhe Misionet Ndërkombëtare Nazaretase kanë pasur ndryshime në udhëheqje. Si gjithmonë, kur ndodh ndryshimi, ai përfshin tranzicion, lëvizje, marrje përgjegjësisë dhe përcaktimin e rrugës përpara. Me hirin e Zotit, rruga përpara është e qartë SË BASHKU!

Jim Ritchie, i cili më parë ka qenë Drejtor Rajonal i Euroazisë, dhe Cheryl Crouch, një ish-mësuese dhe shkrimtare e frytshme e librave misionarë për fëmijë, i'u përgjigjën me mirësjellje pyetjeve të intervistës, duke treguar një ndjenjë të qartë të unitetit me të cilën e shohin Misionin e Perëndisë përmes Kishës së Nazaretasit.

Ritçi e përcakton punën e Misioneve Globale shumë thjesht. "Një kishë lokale me një zemër globale dhe një kishë globale me një familje lokale." "Zoti na ka

urdhëruar të përmbushim misionin e Tij dhe përgjigjja jonë është që ne të përgatisim njerëz, të thirrur nga Zoti, ndërsa i dërgojmë deri në skajet e tokës ose deri në fund të rrugës." "Dr. Briz dhe Dr. Rejnold me shumë mundësi do të pyesnin:
'Nëse një Kishë Nazaretase nuk është njëkohësisht globale edhe lokale, a është vërtet një kishë Nazaretase?'"

*Krouç e përkufizon punën e Misionit Ndërkombëtar Nazaretas përmes Deklaratës së tyre të Identitetit: "MNN-ja është **përkrahësi** i misioneve globale në çdo kishë lokale, e cila **kultivon** një frymë misionare duke **l** **përgatitur** në veprim, dhe duke **ndikuar** te njerëzit në mbarë botën."*

"Kjo gjë e ka përforcuar akoma edhe më tepër mënyrën se si unë e kam kuptuar dhe menduar gjatë gjithë jetës sime MNN-në. Dhe me Zonat tona të Ndikimit, përmes lutjes dhe besnikërisë në dhënie përmes Fondit të Ungjillizimit it Botëror (FUB), ne jo vetëm që i dërgojmë dhe i mbështesim misionarët – e cila është një nga pikat tona të forta - por ne gjithashtu i kujtojmë çdo kishë lokale mundësinë që ata kanë për t'u bashkuar në misionin global të Perëndisë përmes Kishës së Nazaretasit."

Kur u pyetën se cilat kanë qenë zbulimet më pozitive që kanë bërë që nga marrja e detyrës, përgjigjet e Xhim dhe Sheril plotësuan dhe përfunduan njëra-tjetrën:

Xhim -

"Jam shumë i impresionuar nga angazhimi këmbngulës dhe i palëkundur i Kishës së Nazaretasi t për të arritur të humburit përmes ungjillizimit, dhembshurisë dhe edukimit."

Sheril -

*"Gëzim i pamasë që shoh te Nazaretasit kudo që shkoj... është me të vërtetë një pohim se ajo që besoja për kishën tonë është e vërtetë! Shoh një fllad freskie të Frymës që fryn nëpër kis hë dhe përgjigja e popullit të Perëndisë është GËZIM!" **Xhim -***

"Po, është një riafirmim që tregon se

po vjen një brez, i apasionuar për Jezusin dhe për misionin e Perëndisë.

Ne jemi këtu për t'i ndihmuar ata të zbulojnë thirrjen e Perëndisë në jetën e tyre." **Sheril -**

"Ka kaq shumë njerëz të talentuar dhe me dhunti të ndryshme që po

*e derdhin jetën e tyre në shërbim të Perëndisë dhe kishës... është frymëzuese!" **Xhim-***

"Gjithashtu,

ka një përputhje zemre dhe një atmosfere të qëndrueshme kudo që shkoj - qoftë në një qendër t ë madhe urbane, apo në një mjedis të vogël rural

– është e njëjta zemër që shprehet me gëzim për shenjtëri në mision"

Kur u pyetën se si mund të lutet kisha për këto dy struktura jetësore të misionit dhe punën e tyre, Sheril tha: *"Lutuni që të gjithë Nazaretasit të mund të kujtojnë se janë pjesë e MNN-së dhe për këtë arsye mund të zgjedhin të angazhohen plotësisht në përkrahjen për misionet gl obale dhe të marrin pjesë në atë që Perëndia po bën në të gjithë botën përmes Kishës së Nazaretasit."*

Xhimi shtoi: *"Lutuni duke menduar që çdo lutje ndërmjetësuese ka një emër dhe fytyrë..."*

'Zot, ndihmoji njerëzit në...'

Ne i japim kishës lutëse informacion të mjaftueshëm për të mbushur dhe përmbushur kohën e t yre në mënyra ndërmjetësuese që mund të ndryshojnë njerëzit dhe situatat duke prekur zemrën dhe dorën e Perëndisë."

LUTET

- Lutuni për 'Kauzën', ndërsa i bëjmë thirrje një brezi të ri për mision.*
- Lutuni për pjesëmarrje të plotë të kishës në të gjithë botën në misione dhe për mbështetjen e misioneve.
- Lutuni që Nazaretasit kudo që janë do të bashkohen për 24 Orë në Lutje për Misionet Globale** (5-6 Dhjetor 2025) dhe Java Globale e Lutjes (që ndodh më 1-7 Mars 2026).
- *Jezusi është Zot dhe ende i thërret njerëzit në misione, dhe njerëzit thonë "PO" në të gjithë botën. Me 'Kauzën' po i japim këtij brezi dhe brezave të ardhshëm, mundësi për t'u përfshirë në misione në të gjithë botën; dhe përgjigja, deri më tani, ka qenë jashtëzakonisht inkurajuese. Kjo u ofron të gjithë atyre që përkrahin misionin global diçka që të dinë si të përfshihen në mënyra dinamike dhe personale." [Jim Ritchie]
- ** Vitin e kaluar patëm për herë të parë 24 Orë Lutje të Misioneve Globale, e quajtur "Deri në skajet e Tokës",. Gjatë një periudhe prej 24 orësh, të ndara në gjashtë segmente, secili rajon përdori katër orët e tij për të ndërmjetësuar për botën. U përdorën mbi 3,500 linja dhe pajisje.



Lëvdim

- Lavdi Zotit për bashkëpunimin midis Misioneve Globale dhe Misioneve Ndërkombëtare Nazaretase që po kontribuojnë në ndërgjegjësimin dhe entuziazmin për misionin e Zotit përmes Kishës së Nazaretasit.
- Lavdi Zotin për 'ditën e re' që po përjetojmë në kishë, duke punuar së bashku me drejtuesit në të gjithë botën.



A mund të shërbeni?

Nëpërmjet 'Kauzës', Zoti mund të hapë mundësi për ju që të përfshiheni më shumë në misionin e Tij në të gjithë botën. Për më shumë informacion rreth 'Kauzës', [klikoni këtu](#).

NMI Central është i disponueshëm në një arkiv PDF të kuruar. Për të lexuar botimet e mëparshme, [klikoni këtu](#).



KISHA  NAZARENIT
MISSIONET NDËRKOMBËTARE
NAZARETASE